



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më datë 14.06.2019

VENDIM

Nr.224, datë 14.06.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 14.06.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monamenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: “Ndërtim i Hec Ostroku”, Kalimash, Bashkia Kukës, me subjekt aplikues “REAL ENERGY” sh.p.k.;
 - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture : *Banesa e Asllan Fetahut në fshatin Bicaj (Nuri Shaqiri Dhe Nezir Asllani), Bashkia Kukës;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

